**REPUBLIKA E SHQIPERISE**

**BASHKIA KRUJE**
**KESHILLI BASHKISE**

**Nr _______Prot** **Kruje,me _____/_____/2017**

**VENDIM**

**Nr. 79 date 06.02.2017**

**"Per miratimin mbi vleresimin e demeve ne orendi dhe paisje te familjeve te z. Shyqyri Sadik Deda dhe z. Lik Hamdi Balliu"**

Keshilli i Bashkise, ne mbledhjen e tij te dates 06.02.2017, pas shqyrtimit te relacionit te paraqitur nga Bashkia Kruje ,ne mbeshtetje te ligjit nr 139/2015"Per vetqeverisjen vendore", ligjit nr. 8756 date 26.3.2001 "Per Emergjerncat Civile", I ndryshuar,VKM nr 329 date 16.05.2012 " Per krieteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera", i ndryshuar, Udhezimit te perbashket te Ministrise se Brendshme dhe Ministrise se Financave nr.263 date 25.04.2013 "Per kriteret dhe procedurat e dhenies se ndihmes shteterore financiare per mbulimin e demeve te shkaktuara nga fatkeqesi natyrore ose fatkeqesi te tjera te shkaktuara nga veprimtaria njerezore", process-verbalit te konsttatimeve te demeve te shkaktuara, shkresn e Keshillit te Qarkut mbi vleresimet e eksperteve per demet ne orendi, paisje dhe mobilje,

**VENDOSI**

1-Miratimin e vleres se orendive dhe paisjeve sipas preventivit te Keshillit te Qarkut Durres per z. Shyqyri Sadik Deda, ne shumen 203.000 ( dyqind e tre mije) leke.

...ratimin e vleres se orendive dhe paisjeve sipas preventivit te Keshillit te Qarkut ...rres per z.Lik Hamdi Balliu , ne shumen 308.000 ( treqind e tete mije) leke.

3- Bashkia Kruje per mungese fondesh i propozon Ministrise se Puneve te Brendshme ,Drejtorise se Emergjencave Civile, dhenien e shumes prej 103.000 (njeqind e tre mije)leke , qe eshte diferenca ndermjet vleres se demeve ne orendi dhe paisje ne shumen 203.000 leke per z. Shyqyri Sadik Deda dhe ndihmes financiare te dhene me Vendimin e Keshillit te Bashkise Kruje , ne shumen 100.000( njeqind mije ) leke.

4-Bashkia Kruje per mungese fondesh i propozon Ministrise se Puneve te Brendshme ,Drejtorise se Emergjencave Civile, dhenien e shumes prej 208.000 ( dyqind e tete mije) leke , qe eshte diferenca ndermjet vleres se demeve ne orendi dhe paisje ne shumen 308.000 ( treqind e tete mije) leke per z. Ilmi Hamdi Balliu dhe ndihmes financiare te dhene me Vendimin e Keshillit te Bashkise Kruje , ne shumen 100.000 ( njeqind mije) leke.

5- Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen Drejtoria e Sherbimeve Publike dhe Sektori i Emergjencave Civile.

6-Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes.

**KRYETARI**

**Hysni CACA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA KRUJE -